



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:061931

Datë: 06.02.2025

Numri i dokumentit: 06893525

2024:061932

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.K. nga ..., për shkak të veprës penale Lajmërimi apo kallëzimi i rrem nga neni 382 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.71/24 të datës 22.02.2024, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor publik më datë 20.01.2025, në prani të Prokurorit të shtetit Ibadete Hamiti, të dëshmitarit S. L. dhe të akuzuarit dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 06.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari J.K., nga i ati M., e ëma N., e gjinisë L., i lindur me dt..... në fsh....., me vendbanim në rr.”...” nr....., me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike (shih kartelen e ndihmës sociale nga QPS Hani Elezit nr. e dt.), shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovë, i dënuar më parë për vepër penale, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse me datën me datë 17.12.2023, rreth orës 13:29, në Ferizaj, i pandehuri me dashje bënë lajmërimin e rremë tek personi zyrtar i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo ndjekur, ashtu që ditën kritike i pandehuri e kishte denoncuar rastin pranë Inspektoratit Policor të Kosovës kinse zyrtarët policor F. R. dhe S. L. kanë kryer veprën penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ashtu që fillimisht përmes rrjetit social “viber”, i pandehuri kishte shkruar mesazhin “*Komuna Ferizaj, lagjia e re, rruga Astrit Bytyqi kan mare pare dy polic të trafikut prej meje*”, pastaj edhe përmes bisedës telefonike bënë lajmërim të rremë, në atë mënyrë se kinse i pandehuri pasi kishte parkuar veturën në trotuar në mënyrë që të mos i shqiptonin fletëparaqitjen për kundërvajtje ndaj tij, zyrtarët policor kishin kërkuar dhe pranuar para nga i njëjti në shumën prej 15 euro, ndërsa pasi Inspektorati Policor i Kosovës kishte intervistuar dëshmitarët e rastit, të pandehurin dhe pasi i kishte analizuar video-incizimet që ishin marr nga biznesi Salloni i ondulimit “....”, kishte rezultuar se lajmërimi dhe deklarata e të pandehurit nuk ishin të vërteta gjegjësisht lajmërimi ishte i rremë.

-Me këtë ka kryer veprën penale Lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 paragrafi 1 të KPRK- së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46 47,48, 49, 69 ,70 dhe 382 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neni 364, 452, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të akuzuarin e :

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4 /katër/ muajve. Dënimi i shqiptuar me burg nuk do të ekzekutohet me kusht që i akuzuari brenda afatit prej 1 /një/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi nuk kryen veprën tjetër penale (koha verifikimit), në të kundërtën dënimi i tillë do të revokohet.

I akuzuari konform nenit 452 paragrafi 4 të KPPRK-së, lirohen nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të paushallit gjyqësor dhe nga obligimi për kompensim të Viktimave të Krimit, meqenëse i njëjti e kanë gjendjen e dobët ekonomike, është shfrytëzues i asistencës – ndihmës sociale (shih. Kartonin e QPS Hani Elezit nr. të dt.) dhe pagesa e këtyre shpenzimeve do ti vështirësonte edhe më tepër gjendjen e tij ekonomike.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr. 71/24 të datës 22.02.2024, ka ngarkuar të akuzuarin për veprën penale Lajmërimi apo kallëzimi i rrem nga neni 382 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i akuzuari gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 20.01.2025, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit Ibadete Hamiti, dëshmitari S. L. dhe i akuzuari .

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 319 par.1 dhe 2 të KPPRK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, më tej shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga prokurori i shtetit. Gjyqtari pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, konform nenit 321 paragrafi 1 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën me ngarkon aktakuza e prokurorit të shtetit, pranimin e fajit e bej ne mënyrë vullnetare, jam i njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë, jam penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të bute.

Pasi që i akuzuari deklaroi se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, gjyqtari në kuptim të nenit 322 par 2 të KPPRK-së, morri mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale kallëzim apo lajmërim i rreme nga neni 382 par.1 të KPRK-së, dhe për më tepër do të deklarohem në fjalën përfundimtare.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë, Deklarata e dëshmitarit F. R. e dhënë para hetuesve të IPK-së, me dt.15.01.2024, Deklarata e dëshmitarit S. L. e dhënë para hetuesve të IPK-së, me dt.15.01.2024, Deklarata e dëshmitarit E. B. dhënë para hetuesve të IPK-së, me dt.21.12.2023, Deklarata e rrejshme e datës 19.12.2023, e të pandehurit J.K. dhënë para hetuesve të IPK-së, Deklarata e të pandehurit J.K. dhënë para hetuesve të IPK-së, me dt.15.01.2024 (2), Raporti informues i dt. 19.12.2023, Komunikimet në rrjetin social “viber” (2) faqe, Fletëparaqitja për kundërvajtje e dt. 17.12.2023, CD-ja me video – incizime si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Pasi që Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në përputhje me kërkesat nga neni 242 par. 2 KPPK-së, konform nenit 322 paragrafi 4 të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar, mbetem në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridike të veprës penale kundër të akuzuarit J.K. për shkak të veprës penale kallëzim apo lajmërim i rreme nga neni 382 par.1 të KPRK-së, pasi që një pranim i tillë nga ana e tij është bërë në mënyrë vullnetare dhe korrekte duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPPK-së dhe në mbështetje të provave dhe fakteve që i përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal sipas ligjit. Përkitazi me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të paraparë në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethanë rënduese të merr parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimin i fajësisë.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi jam penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Lajmërimi apo kallëzimi i rrem nga neni 382 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe i akuzuari u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari e ka bërë pranimin e fajësisë, se nuk ka dëshmi se i njëjti para kryerjes së kësaj vepre penale të jetë dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale. Bazuar në rrethanat e sipërpërmendura të akuzuarit ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se edhe me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ndaj tij.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë dhe se për herë të parë ka kryer vepër penale do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, e në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërisë dhe autoritetin e tij, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale (preventiva gjenerale)

Vendimi mbi shpenzimet paushallë dhe të kompensimit të viktimave të krimit, është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 4 të KPPRK-së.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2024:061932 datë 06.02.2025

Zyrtare ligjore

Gjyqtari i vetëm gjykses:

Kimete Bytyqi

Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.